

DEKLARATË
PËR VIZITËN E PRESIDENTIT TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS,
ZOTIT GEORGE W. BUSH, NË SHQIPËRI MË 10 QERSHOR 2007

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë përshëndet vizitën e Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zotit George W. Bush, në Shqipëri më 10 qershor 2007, që është edhe vizita e parë e një Presidenti të SHBA-së në vendin tonë.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë e konsideron këtë vizitë si historike, si ngjarjen më kulmore në marrëdhëniet e shkëlqyera miqësore midis popullit shqiptar dhe popullit amerikan, midis Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Kjo vizitë është një vlerësim i madh i ndjenjave thellësisht miqësore të shqiptarëve, i mirënjohjes së kombit shqiptar për rolin e rëndësishëm që SHBA-ja ka luajtur që nga krijimi i shtetit shqiptar e deri në ditën e sotme në forcimin e demokracisë dhe shtetit ligjor.

Vizita është dëshmi dhe fryt i një bashkëpunimi të shkëlqyer dhe luajal 15-vjeçar midis Shqipërisë dhe SHBA-së në të gjitha fushat. Mbështetja e Presidentit Amerikan dhe e Kongresit për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO është një veprim largpamës politik, i cili na inkurajon për arritjen e standardeve të kërkuara për integrimin në NATO, si edhe një mbështetje për marrjen e ftesës për anëtarësim në samitin e ardhshëm.

Vizita është një vlerësim i rolit dhe kontributit aktiv që Shqipëria ka dhënë dhe jep në luftën kundër terrorizmit dhe në operacionet në mbështetje të paqes, si një aleate e qëndrueshme e SHBA-së në këtë fushë.

Presidenti Bush vjen në Shqipëri në një moment të rëndësishëm historik për Shqipërinë, rajonin dhe Kosovën. Kuvendi i Shqipërisë përshëndet deklaratën e përbashkët të Presidentit të SHBA-së G.W.Bush, Kancelares së Republikës Federale të Gjermanisë Anxhela Merkel dhe Presidentit të Komisionit European Hoze Manuel Barroso për Kosovën në Samitin e Bashkëpunimit SHBA-BE dhe vlerëson që ky qëndrim i përbashkët ka një rëndësi përcaktuese për paqen dhe stabilitetin në Kosovë dhe rajon.

Kuvendi i Shqipërisë do të vazhdojë të mbështesë të gjitha përpjekjet e NATO-s dhe BE-së për sigurinë dhe paqen në rajon dhe më gjerë, duke dhënë në vazhdimësi kontributin e vet.

7 maj 2007